VENDIM
Nr. 470, datë 29.06.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT
"ALB-WEST"

SUBJEKTIT JURIDIK: SHOQËRIA "ALBANIA BY ATY" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor" të miratuar me vendimin nr.355, pika 1, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.450, datë 27.04.2006 të KKRT-së "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë", si dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit juridik, shoqërisë "Albania By Aty" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vorës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj